REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANE
Nr. 29207 Vendimit

29207

# V E N D I M

## PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me daten 03.03.2003 une gjyqtare [signature] e Gjykates se Shkallës së Parë Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e administratorit Enjti PAZAJ per regjistrim ne regjistrin tregetar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ESSEL " ShPK Korçë dhe

## KONSTATOVA:

Se kerkuesi eshte edhe administrator i shoqerise dhe ka paraqitur prane kesaj gjykate aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "ESSEL ", i cili eshte firmosur me daten 20.02.2003 prej ortakëve themelues të shoqërisë Enjti PAZAJ dhe Aleksandros BALAPANIDHIS. Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga" Partizani " Nr.1 Korce. Ajo do te zhvilloje veprimtarine me nje afat 10 vjecar, duke patur per objekt te veprimtarise se saj: - Prodhimi dhe tregëtimi i bojrave , llakut , plastikove, stukove, etj., dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit.; - Tregëti të artikujve të ndryshëm te ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakice; - Tregëti e karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apo dhe konfeksioneve ; - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit ; import – eksporte.Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga kontributi ne para. Kapitali eshte i ndare ne 100 pjese me vlere 1000 leke te nje pjese, i zoteruar nga 50 % për secilin ortak .

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE:

ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993

## V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te Shoqerise Tregetare " ESSEL " ShPK, me adrese: Rruga" Partizani " Nr.1 Korce, me ortakëve themelues të shoqërisë Enjti PAZAJ dhe Aleksandros BALAPANIDHIS, me administrator të shoqërisë z. Enjti PAZAJ . Ajo do te zhvilloje veprimtarine per nja afat prej 10 vjet, duke patur per objekt te veprimtarise se saj: - Prodhimi dhe tregëtimi i bojrave , llakut , plastikove, stukove, etj., dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit.; - Tregëti të artikujve të ndryshëm te ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakice; - Tregëti e karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apo dhe konfeksioneve ; - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit ; import – eksporte. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga kontributi ne para, i zoteruar nga 50 % për secilin ortak . Kapitali eshte i ndare ne 100 pjese me vlere 1000 leke te nje pjese.

Zyra e regjistrit tregetar te beje regjistrimin e shoqerise.Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE
[signature]

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANE**

**Nr.___29.207 / 1___i Vendimit**

# VENDIM

## I GJYQTARIT TË VETËM

Në Tirane, sot në daten 16.7.2004, une gjyqtare [signature] e Gjykates se Shkallës së Parë Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e administratorit Enjti PAZAJ , per rregjistrimin dhe depozitimin e ndryshimit të pjesëmarrjes së ortakëve në pronësinë e shoqërisë sipas kontratës së shitblerjes si dhe emrimin e Ekspertit të kontributeve për zmadhimin e kapitalit themeltar , të përcaktuara këto me vendimin e Ansamblesë së ortakëve të Shoqerise Tregetare " ESSEL " Shpk Korçë, nga

**KONSTATOVA:**

Shoqëria tregëtare "ESSEL"SHpk është rregjistruar si person juridik me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Nr. 29.207 datë 03.03.2003, me kapital themeltar 100.000 lek në pronësi të dy ortakëve themelues , në kushtet e kontratës datë 20.02.2003 të lidhur midis tyre ku janë të barabartë me 50 % vetëm për shpërndarjen e fitimit nga cikli i prodhimit që realizohet nga aktiviteti i shoqërisë , me objekt Veprimtarie "- Prodhimi dhe tregëtimi i bojrave , llakut , plastikove, stukove, etj., dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit.; - Tregëti të artikujve të ndryshëm te ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakice; - Tregëti i karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apodhe konfeksioneve ; - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit ; import – eksporte ".

Me kontratën e shitblerjes Nr. ______Rep _____Kol të datës 01.07.2004, e miratuar kjo me Vendimin e Ansamblesëse ortakeve Nr. 1 date 01.07.2004, ortaku Aleksandros BALAPANIDHIS në cilësinë e shitsit, ka shitur tek ortaku blerës Enjti PAZAJ , pjesën e tij prej 50 % të kapitalit të nënshkruar , ose 1 / 2 e këtij kapitali , ose e shprehur në vlerë 50.000 lekë . Në këtë mënyrë ortaku blerës Enjti PAZAJ , mbas blerjes së pjesë , në shoqëri ngelet **ortak i vetëm** , i cili zotëron në shoqëri si pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë 100 % të tij , kurse ortaku shitës Aleksandros BALAPANIDHIS largohet nga shoqëria.

Gjithashtu për vlerësimin e kontributeve në natyrë të investuara kryesisht nga ortaku Enjti PAZAJ, për efekt të vlerësimit të tij dhe realizimin e transaksionit për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, të emërohet si Ekspert Kontributesh , Eksperti Kontabël i Autorizuar z.Bashkim GJATA .

Mbështetur mbi dokumentacionin e paraqitur , kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

Në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 10.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " si dhe të Ligjit Nr. 7667 datë 28.1.1993 " Për rregjistrin tregëtar "

## V E N D O S A :

1-Të depozitohen Vendimi i Ansamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë "ESSEL " Shpk Korçë si dhe Kontrata e shitblerjes së Kapitalit themeltar, për ndryshime në pjesëmarrjen e pronësisë së shoqërisë, sipas së cilës ortaku shitës Aleksandros BALAPANIDHIS largohet nga shoqëria, dhe ortaku Enjti PAZAJ , mbas blerjes së pjesës në shoqëri ngelet ortak i vetëm dhe zotëron në shoqëri si pjesëmarrje 100 % në kapitalin themeltar të shoqërisë.

2- Për vlerësimin e kontributeve në natyrë të investuara kryesisht nga ortaku Enjti PAZAJ, dhe realizimin e zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, të emërohet si Ekspert Kontributesh , Eksperti Kontabël i Autorizuar z.Bashkim GJATA

3- Nga Zyra e Personave Juridikë të bëhen rregjistrimet përkatëse në Rregjistër në kolonën 4 , gërma ë dhe g , për ndryshimet të pronësisë dhe në kolonën 2 , gërma c, për vlerën e kapitalit themeltar të shoqërisë " ESSEL " Sh.p.k Korcë.

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë.

GJYQTARE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT TIRANË**
**Nr. 20.207 / 2 i Vendimit**

# VENDIM
## I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, në datën 08.10.2004 unë Gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë ____________, mbasi u njoha me kërkesën e kërkuesit Enjti PAZAJ , Administrator i shoqërisë "ESSEL" Shpk Korce, i cili kërkon që të depozitohet Vendimi i Ortakut të vetëm Nr.2 datë 20.07.2004, nga

## Konstatova:

Me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë Nr. 29 207/1 datë 16.07.2004 u realizua shitblerja e pjesës së ortakut duke ngelur ortak i vetëm Enjti PAZAJ, i cili zotëron 100 % të kapitalit të nënshkruar si dhe u bë emërimi i Ekspertit të kontributeve Bashkim GJATA.

Me Vendimine Ortakut të vetëm Nr. 2 datë 20.07.2004, eshtë bërë miratimi i Raportit të Ekspertit të kontributit Bashkim GJATA për zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë për shumën **5.100.000** lekë me vlerësimin e kontributeve në natyre si makineri, paisje dhe inventar ekonomik, si dhe me vlerën **600.000** lek , zmadhmim kapitali në para nga fitimet neto , gjithejt për shumën **5.700.000** lekë . Me këtë rast janë bërë dhe ndryshime në nenin 5 të Akt themelimit dhe 12 të Statutit të shoqërisë dhe konkretisht : -"Kapitali themeltar i shoqërisë është **5.800.000** lekë . Ky kapital përbëhet nga të holla dhe nga kontributet në natyrë, dhe me vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet . Nuk lejohet që kapitali themeltar i shoqërisë të përfaqësohet nga letra të tregëtueshme apo me shërbime.

Miratohet ndarja në pjesë e kapitalit themeltar dhe vlera e një pjese nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë . Gjithsejt vlera e pjesëve të Kapitalit themeltar të shoqërisë shkon në masën **580** pjesë, të cilat janë 100 % në pronësi të ortakut të vetëm themelues, të ngelur në shoqëri .

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë , mund t'i rikthehet ortakut të vetëm ose ortakëve ( në rast shtimi të tyre në shoqëri), vetëm me rastin e likujdimit të shoqërisë , ose në rastin e tërheqjes së kuotës dhe pjesës së tij , duke mbajtur parasysh zhvillimin dhe rezultatin e aktivitetit të shoqërisë ".

Përsa më sipër, mbështetur në gjykimin e bërë, dokumentacionin e paraqitur për këtë qëllim, kërkesa është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar

## PËR KËTO ARËSYE :

Në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 10.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " si dhe të Ligjit Nr. 7667 datë 28.1.1993 " Për rregjistrin tregëtar "

## VENDOSA:

1-Të depozitohet Vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë "ESSEL" Sh.p.k. Korce për zmadhmin e kapitalit themeltar të shoqërisë nepermjet kontributit ne natyredhe në para nga fitimet neto, në shumën **5.700.000** lekë

2- Në Statutin e shoqërisë janë bërë këto ndryshime

Neni 12 i Statutit ndryshuar si vijon :

-"Kapitali themeltar i shoqërisë është **5.800.000** lekë . Ky kapital përbëhet nga të holla dhe nga kontributet në natyrë, dhe me vendim të ortakut të vetëm mund të shtohet . Nuk lejohet që kapitali themeltar i shoqërisë të përfaqësohet nga letra të tregëtueshme apo me shërbime.

Miratohet ndarja në pjesë e kapitalit themeltar dhe vlera e një pjese nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë . Gjithsejt vlera e pjesëve të Kapitalit themeltar të shoqërisë shkon në masën **580** pjesë, të cilat janë 100 % në pronësi të ortakut të vetëm themelues, të ngelur në shoqëri

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë mund t'i rikthehet ortakut të vetëm ose ortakëve ( në rast shtimi të tyre në shoqëri), vetëm me rastin e likujdimit të shoqërisë , ose në rastin e tërheqjes së kuotës dhe pjesës së tij , duke mbajtur parasysh zhvillimin dhe rezultatin e aktivitetit të shoqërisë . ".

3-Nga Zyra e Personave Juridikë të bëhen rregjistrimet përkatëse në Rregjistër në kolonën 2 , gërma c, për vlerën e kapitalit themeltar të shoqërisë "ESSEL" Sh.p.k Korce.

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë.

**GJYQTARE**

( ________________ )

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**

**Nr.** 29207/3 **Vendimit**

# VENDIM
# I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 09/05/ 2007, Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane,Blerina MUÇA,pasi shqyrtova kerkesen e administratorit Z. Jetnor Kulla,per depozitim ne regjistrin tregtar te Vendimit Nr. 9, date 07.10.2006, te Ortakut te vetem te shoqerise "ESSEL" sh.p.k

## KONSTATOVA

Se me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.29207,date 03.03.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria **"ESSEL"sh.p.k** me administrator Z.Enjti Pazaj.

Me Vendimin Nr.9,date 07.10.2006,te ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur:

1. Miratohet me efekt te menjehershem doreheqja e administratorit te shoqerise Z.Enjti Pazaj.
2. Emerohet Administrator Z.Jetnor Kulla,lindur me 20.05.1963,shtetas shqiptar,banues ne Korçe.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

## PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667,date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar" dhe Ligjit Nr.7638,date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",

## VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin e kerkeses,vendimit te asamblese se ortakeve Nr.9,date 07.10.2006,te paraqitura nga shoqeria "ESSEL" sh.p.k
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

**GJYQTARE**
**BLERINA MUÇA**

**Nr** **Rregjistrimi .** 23207.

**URDHER RREGJISTRIMI**

Emri : "ESSEL" shpk.

Selia : Rruga "Partizani" Nr 1. Korçe"

Objekti: Tregti, Prodhim i bojrave, mat. ndertimi, industriale, ushqimore, kuinc kadomande me pakice, konfeksione, te Sanal, aktivitet turistik, import eksport

Kapitali : 100.000 (njëqind mijë) lekë"

Ortaket : Engjëll Pataj, Aleksandros Balaponidis secili 50%.

Administrator: Engjëll Pataj

Kohezgjatja : 10 vjet

Statuti : 7 flete + 1 N.

Akti i Themelimit : 3 flete

Data e nenshkrimit te Statutit : 26.02.03

Data e Rregjistrimit ; 03.03.2003

**Shenime** - Kuponi bankare Nr 50026562000 1 dt. 26.02.2003 i "FEFAD BANK" dega Korçe".

**G J Y Q T A R E**

**BLERINA MUÇA**

# AKT THEMELIMI
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me daten 20 Shkurt 2003 ne Korçë, ne Ortakët themlues të ardhshëm të shoqërisë, zotërinjtë :

1. **Enjti Safet PAZAJ** , i datëlindjes 1954 , lindur në Vlorë dhe banues në Korçë, me pasaporte Z 0166930;
2. **Aleksandros Athanasios BALAPANIDHIS,** i datëlindjes 1974, lindur dhe banues në Ptolemaidha – Kozan, me Nr. Pashgaporte N 813723 ;

në mbështetje të ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 " Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë e veprimtarive të pavarura e privatizimit" , ligjit Nr 7632 date 04.11.1992 " Dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit tregëtar " si dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " , vendosëm te krijojmë nje shoqeri tregetare te formes dhe me permbajtjen e meposhtme:

Neni 1

Themelohet ne Korçë shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur " ESSEL" Shpk .Qendra dhe selia e saj ndodhen ne adresen: Rruga "Partizani" Nr. 1 . Shoqeria mund te krijoje dege , filiale dhe agjensi në qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashtë vendit .

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj do te zhvillohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fushen e prodhimit, tregetimit, doganore, tatimore dhe ne te gjithe veprimtarine juridiko-civile.

Neni 3

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj: - Prodhimi dhe tregëtimi i bojrave , llakut , plastikove, stukove, etj., dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit.; - Tregëti të artikujve të ndryshëm te ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakice; - Tregëti i karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apodhe konfeksioneve . - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit ; import – eksporte. Me vendim të ortakëve mund të shtohet në të ardhmen objekti i veprimtarisë edhe në fusha të tjera.

Neni 4

Veprimtaria e shoqerise do te zgjate me afat 10 vjecar. Veprimtaria do te filloje mbas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe perbehet nga kapitali ne para i depozituar prane Deges se Bankes ______________, të cilat u derdhën me Mandat Arkëtimi Nr______________Pjesmarja ne kete kapital eshte e barabarte me 50% te vleres. Ai eshte i ndare ne 100 pjese me vlere 1000 leke sejcila.

Neni 6

Ortakët mbajnë pergjegjesi per shkeljet e fajshme qe ka sjelle deme ne veprimtarine ekonomike-financiare te shoqerise.

Humbjet perballohen prej tyre deri ne masen e kapitalit te investuar ne shoqeri.

Neni 7

Fitimi i realizuar nga shoqeria iu perket ortakëve , mbasi shlyhen te gjitha detyrimet qe ka shoqeria ndaj organeve doganore, fiskale, administrative dhe ndaj te treteve, si dhe krijimit te fondit te "rezerves se domosdoshme".

Midis palëve Ortakët e shoqërisë ranë dakort që për ciklin e prodhimit në fabrikën e bojrave, llakut , plastikove, stukove, etj., të cilat vinë si rezultat i investimit të njëjtë e të barabartë në kapital të nënshkruar dhe atij për makineri dhe paisje si dhe për lëndët e para , ndarja e fitimeve do të llogaritet midis tyre mbi koston + fitimin = çmimin e shitjes me shumicë, ku pasi të zbriten shpenzimet e taksat , fitimi neto i rezultuar , të ndahet në në mënyrë të barabartë sipas pjesëmarrjes në këtë kapital ( me 50 % për secilin ortak) .

Kurse për ciklin e qarkullimit të mallit jashtë njësisë së prodhimit për në njësitë e shitjes më shumicë dhe pakicë, për fitimet neto të rezultuara nga ky qarkullim , të ndahen mbi raportin e vlerën së parave të futura në qarkullim. Raport ky i dalë nga totali i principalit të kapitalit qarkullues, ku për çdo rast qarkullimi dhe shitjeje mallrash për të tretë apo dhe në dyqanet e filialeve dhe degëve të shoqërisë, midis ortakëve të bëhët me marrëveshje të veçantë.

Neni 8

Mbas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar, ajo do te paraqitet ne qarkullimin civil tregetar, mbasi te pajiset me lejen per ushtrim profesioni nga organi tatimor.

Afati i veprimtarise mbaron me plotesimin e kohes se parashikuar ne kete akt themelimi. Ortakët mund te heqin dore nga shoqeria para perfundimit te afatit, sipas kushteve te lejuara nga statuti.

Neni 9

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqerise si dhe investimet e saj, ne baze te ligjit, do te gezojne mbrojtjen e shtetit, i cili krijon kushtet per ushtrimin e veprimtarise si per te gjithe personat juridike.

Neni 10

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- ortaket themelues
- administratori;
- kontrolli i shoqerise kryhet nga eksperti kontabel i autorizuar

Neni 11

Ortakët si dhe te punesuarit ne shoqeri, jane te detyruar te ruajne sekretin e krijimit, te veprimtarise si dhe ato fakte, qe jane te destinuara te mbeten sekrete te shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi ne rastet kur vertetohet se i jane shkaktuar deme shoqerise nga mosrespektimi me dashje ose nga pakujdesia i kesaj dispozite.

Neni 12

Ne rastet kur ortakët heqin dore nga shoqeria para perfundimit te afatit, mban pergjegjesi per shkaktimin e demit shoqerise dhe detyrohet t'i shlyeje ato. Masa dhe menyra e percaktimit te fajesise dhe e shlyerjes se demit eshte ajo e percaktuar ne dispozitat e Kodit Civil ne fuqi, te ligjit "Per shoqerite tregetare" dhe legjislacioni tjeter ne fuqi.

Neni 13

Mosmarreveshjet e lindura dhe qe nuk mund te zgjidhen me pajtim brenda shoqerise, zgjidhen nga gjykata. Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Shkallës së parë ku shtrin aktivitetin shoqëria .

Neni 14

Ky akt themelimi legalizohet para nje noteri, mbasi eshte nenshkruar prej ortakeve themelues.

**ORTAKET THEMELUES**

**(Enjti Pazaj)** **(Aleksandros BALAPANIDHIS)**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER PUBLIK
Nr 1163 rep. kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 26.1.2003 ne Pogradec, para meje u paraqiten shtetasit:Enjti Pazaj, i datelindjes 1954, lindur ne Vlore dhe banues ne Korce, si edhe Aleksandros Athanasios i datlindjes 1974, lindur dhe banues ne Ptolemaidhe.Kozan (Greqi), te cilet deklaruan se jane dakort me akt-themelimin e mesiperm, te cilin e kane nenshkruar vete me doren e tyre, me vullnet te lire e te pavesuar, dhe kerkuan noterizimin e tij.

Nga ana ime nuk shihet ndonje pengese ligjore, prandaj vertetoj sa me siper dhe noterizoj.

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Noter
Thoma BICJA

# S T A T U T

## I SHOQERISE " ESSEL" SHPK

Sot me daten 20 Shkurt 2003 në Korce, ortaket themelues te kesaj shoqerie :

1- **Enjti PAZAJ** , i datelindjes 1954, lindur ne Vlore dhe banues ne Korce, me shtetesi shqiptare
2- **Aleksandros BALAPANIDHIS** i datlindjes 1974,lindur dhe banues ne Ptolemaidhe (Greqi),me kombesi greke, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, hartuan kete statut lidhur me organizimin, administrimin dhe drejtimin e shoqerise.

### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Shoqeria me emrin "ESSEL" ShPK Korce rregullon poziten juridike te themeluesve, te organeve drejtuese te saj si dhe marredheniet me te punesuarit, me personat e trete dhe organet fiskale e administrative në mbeshtetje te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 " Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë e vepriumtarive të pavarura e privatizimit" , ligjit Nr 7632 date 04.11.1992 " Dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit tregëtar " , ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " si dhe Ligjit me Nr 7667 date 28.1.1993 " Për rregjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqërite tregëtatare " si dhe legjislacionin tjeter ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria ka qendren e vet ne adresen:Rruga" Partizani " Nr.1 Korce. Ajo mund te krijoje dege, filiale e agjensi edhe ne rrethe te tjera te Shqiperise si dhe jashtë vendit.

Neni 3

Shoqeria eshte shoqeri shqiptare dhe ka statusin e personit juridik shqiptar.

Neni 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj: - Prodhimi dhe tregëtimi i bojrave , llakut , plastikove, stukove, etj., dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit.; - Tregëti të artikujve të ndryshëm te ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakice; - Tregëti i karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apodhe konfeksioneve ; - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit ; import – eksporte. Me vendim të ortakëve mund të shtohet në të ardhmen objekti i veprimtarisë edhe në fusha të tjera.

Neni 5

Shoqeria pergjigjet per detyrimet qe krijon ne veprimtarine e saj me fondet e veta. Kur keto jane te pamjaftueshme, ortaket mund te vendosin shtimin e kapitaleve të veta deri ne masen qe mbulon humbjet.

Neni 6

Shoqeria per nevojat e veprimtarise se saj nuk pengohet te marre nga cilado banke, qe vepron ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj, kredi ne kushtet e lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 7

Ortaket nuk pengohet te marre pjese ne shoqeri te tjera dhe te krijojne te drejta pronesie personalisht ose me persona te tjere.

Neni 8

Shoqeria eshte "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ku, ortaket perballojne humbjet deri ne masen e kapitalit te investuar. Shoqeria perbri emertimit te saj shenon edhe inicialet "ShPK" si dhe shumen e kapitalit.

Ne kushtet e lejuara nga nenet 73 dhe 77 te ligjit "Per shoqerite tregetare", shoqeria mund te shnderrohet ne shoqeri kolektive, komandite ose anonime.

Neni 9

Shoqeria prishet ne rast se kapitali i nje ortaku per shkak te detyrimeve te tij, i kalon nje ose disa personave te tjere.

Shoqeria prishet edhe ne rastin e vdekjes se njerit prej ortakeve, neqoftese trashegimtaret e tij nuk deshirojne te hyjne ne shoqeri, ose jane te paafte per kete.

Shoqeria prishet gjithashtu ne rast falimentimi, privimi i te drejtave te ortakeve per te ushtruar kete veprimtari ose profesionin e tregetarit, si dhe ne rastin e paaftesise se ortakeve.

## II. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 10

Ortaket kane tagrat e Ansamblesë së shoqërisë dhe i gezojne te drejtat e tyre nepermjet vendimeve qe marrin. Ata kane keto te drejta kryesore:

- Mbikqyrin dhe orientojne veprimtarine prodhuese,tregetuese dhe ekonomiko-financiare te shoqerise;
- Marrin ne cdo faze te veprimtarise dijeni mbi gjendjen e kapitalit dhe llogarive te shoqerise;
- Terheqin ne cdo kohe dokumentacionin kryesor te shoqerise, si raportin e administrimit, inventaret e ndryshme dhe llogarite tremujore e vjetore per tre vjetet e fundit;
- Kerkojne shpjegime per cdo material te paraqitur ne mbledhjen e asamblese se ortakeve, ose kontollojne dokumentat e nevojshme shoqeruese te materialit te paraqitur;
- Marrin nga administratori 15 dite para mbledhjes, raportin e administrimit dhe projektin e vendimeve qe do te shqyrtojne si ortake te shoqerise.
- Miratojne llogarite brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar;
- Kontrollojne cdo aktivitet prodhues e tregetues vete ose me nje ekspert kontabel;
- Ortaku jo administrator ka te drejte t'i paraqese me shkrim dy here ne vit administratorit disa pyetje per probleme qe vene ne dyshim vazhdueshmerine e veprimtarise se shoqerise;
- Heqin dore nga shoqeria ne kushtet e parashikuara nga akti i themelimit dhe statuti.

Neni 11

Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Depozitojne brenda afatit te kerkuar kapitalin themelor ne te holla, ose vene ne disponim te shoqerise kapitalin ne natyre sipas kontrates se themelimit;
- Paguajne, kur eshte rasti, kuoten suplementare per plotesimin e detyrimeve te shoqerise per te perballuar humbjet;
- Percaktojne organet perfaqesuese dhe ekspertet kontabel ne rast mosmarreveshjesh;
- Plotesojne detyrimet e shoqerise ndaj te treteve;
- Informojne organet drejtuese mbi mundesite e permiresimit e zhvillimit te veprimtarise

prodhuese e tregetuese;

## III. KUSHTET EKONOMIKE

Neni 12

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe perbehet nga kontributi ne para i depozituar prane Deges se Bankes_____________Ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese me vlere 1000 leke sejcila, pjesemarrja e dy ortakeve eshte e barabarte me 50%.

Administratori pajis ortaket me dokumentin e derdhjes se kuotes se kapitalit themeltar.

Neni 13

Shoqeria mund te blere pasuri te tjera me te ardhurat e saj, te cilat mund t'i disponoje sipas vendimit te ortakeve.

Neni 14

Emetimi i letrave me vlere, subvencionimi i tyre ose garantimi i letrave te emetuara prej shoqerise eshte i ndaluar.

Cdo marreveshje tjeter ne kundershtim me kete dispozite eshte e pavlefshme.

Neni 15

Pasurite e shoqerise pasqyrohen ne bilancet e saj me vlere te shprehur ne monedhen e vendit ose ne monedhe te huaj, te konvertueshme ne momentin e vleresimit.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.

Neni 16

Kapitali i ortakeve eshte lirisht i transferueshem tek trashegimtaret ligjore dhe tek bashkeshortet ne rast ndarje pasurore. Ai eshte lirisht i transferueshem ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

Kapitali themeltar mund t'u transferohet edhe personave te trete por ne cdo rast te tille duhet ti nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaku tjeter.

Neni 17

Subjektet qe perfitojne nga transferimi, detyrohen te disponojne kapitalin e perfituar per nevojat e shoqerise, duke marre persiper te gjitha te drejtat e detyrimet qe kishte mbajtesi i kapitalit.

Cdo transferim do te evidentohet me shkrim dhe vertetohet nga noteri, duke u bere edhe ndryshimet perkatese ne regjistrin tregetar.

Neni 18

Kapitali fillestar i shoqerise zmadhohet ose zvogelohet me miratimin e ortakeve.

Zmadhimi i kapitalit ne para ose ne natyre behet si ne rastin e kapitalit themeltar ne momentin e krijimit te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit fillestar mund te vendoset nga ortaket te cileve u vihet ne dispozicion projekti i zvogelimit jo me vone se 30 dite para dites qe do te vendosin.

Zvogelimi i kapitalit lejohet vetem ne rastet kur nuk krijon pasiguri tek kreditoret dhe nuk demton interesat e tyre lidhur me kredite e dhena para publikimit te zvogelimit te kapitalit.

Neni 19

Shoqeria disponon lirisht mjetet e saj financiare. Detyrimet qe krijohen,i shlyen me te

ardhurat qe realizon, te administruara ne fonde te vecanta.Kur keto fonde jane te pamjaftueshme, mund te zmadhoje kapitalin themeltar deri ne plotesimin e detyrimeve ndaj te treteve, mbas miratimit nga ortaket.

Shoqeria krijon "rezerven e domosdoshme" nga fitimi neto i vitit financiar, prej te cilit derdh ne kete fond nje vlere prej 1/20 pjese deri ne masen 10% te kapitalit themeltar.

Neni 20

Ne rast se kapitali i shoqerise rezulton me pak se gjysma e kapitalit themeltar, per shkak te humbjeve, ortaket vendosin zvogelimin e kapitalit themeltar, ose ne rast te kundert, prishjen e parakohshme te shoqerise.

Neni 21

Fitimi i shoqerise, qe rezulton mbasi zbritet bilanci negativ i saj i takon ortakeve ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapital si dhe sipas marrëveshjeve të përcaktuar në Aktin e themelimit të shoqërisë . Fitimi eshte lirisht i transferueshem jashte Republikes se Shqiperise.

Fitimi mund te perdoret edhe per investime te tjera ne Shqiperi, per pjesmarrje ne shoqeri te tjera dhe per cdo qellim qe cmohet nga ortaket.

Neni 22

Plani financiar parashikon aktivin dhe pasivin e aktivitetit ekonomik te shoqerise te shprehur ne leke ose ne valute te huaj te konvertueshme ne Shqiperi.

Kontabiliteti do te mbahet ne Shqiperi, por edhe ne vend tjeter ne rast se vendosin ortaket, dhe kontrollohet prej organeve financiare shqiptare.

## IV. ADMINISTRIMI

Neni 23

Organi vendimor i shoqerise perbehet nga te dy ortaket, te cilet vendosin bashkërisht per te gjitha ceshtjet qe merren ne shqyrtim ne perputhje me ligjet per Shoqerite Tregtare. Vendimet evidencohen ne nje regjister te posacem.

Ortaket mund te shqyrtojne ceshtje te ndryshme te shoqerise sa here ata e shikojne te arsyeshme. Per ceshtjet qe shqyrtohen ,ata kane te drejte te kerkojne ndihmen e nje eksperti kontabel të autorizuar , i cili detyrohet te ruaje sekretin profesional.

Neni 24

Ortaket shqyrtojne te gjitha ceshtjet me te rendesishme, si miratimin e aktit te themelimit dhe te statutit te shoqerise, ndryshimet e statutit, bilancin vjetor dhe tremujor, shtimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar, emerimin dhe shkarkimin e administratorit, percaktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise, krijimin e filialeve, te degeve ose agjensive dhe shkrirjen ose mbylljen e aktivitetit te tyre, emerimin e ekspertit kontabel, prishjen e shoqerise dhe caktimin e likuidatorit.

Neni 25

Shoqeria do te administrohet nga Z.Enjti PAZAJ, i cili perfaqeson shoqerine ne te gjithe veprimtarine e saj.

Administratori ka keto kompetenca:

- kryen te gjitha veprimet ne interes te shoqerise, pervec atyre qe shprehimisht i kane ortaket;
- miraton llogarite ekonomike mbas perfundimit te tyre nga administrata;
- pergatit raportin vjetor per veprimtarine e shoqerise dhe ja paraqet ortakeve;

- siguron zbatimin e vendimeve qe marrin ortaket;
- paraqet para ortakeve propozimet konkrete per ndryshimet ne kapitalin themeltar;
- propozon ortakeve mundesine e krijimit te filialeve, degeve dhe zyrave te nevojshme per veprimtarine e shoqerise;
- propozon strukturen e administrates per mbarevajtjen e punes se shoqerise;
- paraqet ortakeve akte qe rregullojne marredhenie me kuadrin ose te punesuarit sipas kompetences;
- perzgjedh e propozon tek ortaket eksperte kontabel dhe likuidatorin;
- propozon numurin e pergjithshem te puntoreve dhe pagat e tyre;
- perfaqeson shoqerine ne organet administrative, gjyqesore, doganore, fiskale e ato te pushtetit dhe zgjidh mosmarreveshjet me te tretet;
- nenshkruan per llogari te shoqerise kontratat,pervec atyre qe ortaket i gjykojne te kompetencave te tyre;
- lidh kontratat individuale e kolektive te punes.

Per te gjitha veprimet e kryera prej tij, administratori mban pergjegjesi para ortakeve.

Neni 26

Administratori është pergjegjes individualisht per demet qe i ka sjelle shoqerise nga shkeljet e statutit, dispozitave ligjore ose veprimeve te tjera me faj te kryera gjate adminsitrimit.

Aktet e administratorit e ngarkojne shoqerine teresisht, me perjashtim kur personat e trete e dinin se veprimi i administratorit kalonte kompetencat e veprimtarise se shoqerise.

Neni 27

Ne rastet kur midis shoqerise dhe ortakve jane arritur marreveshje te caktuara, administratori ben shenimin perkates ne regjistrin e ceshtjeve te shqyrtuara.

## V. EKSPERTI KONTABEL

Neni 28

Shoqeria cakton ekspert kontabel per nje periudhe prej 6 vitesh financiare,te cilet emerohen nga ortaket. Ata emerojne edhe zvendes ekspert kontabel te autorizuar, ne rast mospranimi, pengimi, doreheqje ose vdekje te ekspertit kontabel.

Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi per shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmerine e tyre.

Ata mbajne pergjegjesi per demet qe i shkaktojne shoqerise nga pasaktesia e mbajtjes se llogarive dhe nga verifikimi i gabuar i tyre.

Themeluesit, administratoret, personat e afert gjini te tyre deri ne shkallen e katert te gjinise e krushqise, bashkeshortet e tyre, drejtuesit e filialeve e te zyrave te shoqerise nuk mund te ngarkohen me detyren e eksperteve apo zvendes eksperteve kontabel.

Nuk mund te caktohen eksperte kontabel personat qe kane qene administratore ose te punesuar ne kete shoqeri deri pese vjet nga koha e largimit te tyre nga kjo shoqeri. Eksperti Kontabël i Autorizuar i parë emërohet zoti Bashkim GJATA .

Neni 29

Ne rast gabimi ose pengimi eksperti kontabel i autorizuar shkarkohet nga gjykata me procedure urgjente.

Neni 30

Eksperti kontabel ka keto detyra:

- garanton qe llogarite vjetore jane te rregullta;
- pershtatjen e kontabilitetit me legjislacionin ne fuqi;
- perputhjen e informacioneve te dhena ne raportin e adminstrimit me llogarite vjetore;
- ne cdo kohe te vitit ben te gjitha verifikimet e kontrollet, qe gjykon te nevojshme.

Neni 31

Ekspertet kontabel mund te ndihmohen edhe nga eksperte ose bashkepuntore, qe i zgjedhin vete, duke ja u bere me pare te njohur shoqerise.

Neni 32

Ekspertet kontabel njoftojne ortakun e vetem per verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet qe kane bere.

Neni 33

Ekspertet kontabel paguhen me honorare.

## VI. MARREDHENIET E PUNES

Neni 34

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me marreveshjen per themelimin e shoqerise, dispozitat e statutit te saj dhe legjislacionin shqiptar te punes.

Neni 35

Punesimi ne shoqeri behet sipas kontrates individuale te punes per cdo te punesuar ose grup te punesuarish. Marredheniet midis shoqerise dhe sindikates rregullohen nga kontrata kolektive e punes.

## VII. SHNDERRIMI,BASHKIMI,NDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 36

Shnderrimi i shoqerise ne shoqeri kolektive ose komandite behet me miratimin e ortakeve, ndersa shnderrimi i saj ne shoqeri anonime behet, vetem pasi shoqeria te kete hartuar dhe te kete aprovuar nga ortaket bilancin e dy viteve te fundit te aktivitetit te saj.

Vendimi per shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter merret pasi te paraqitet raporti mbi gjendjen e shoqerise nga nje ekspert per shnderrimin.

Neni 37

Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet ne shoqeri te tjera me vendim te ortakeve.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket dhe kalimin e plote te trashegimise se saj tek shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operaconit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerise qe zhduket marrjen e cilesise se ortakut te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose te ndarjes.

Neni 38

Shoqeria do te vazhdoje veprimtarine pa afat te caktuar, nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar.Veprimtaria e saj mund te nderpritet kur:
- me vendim te ortakeve;
- nuk rezulton rentabel gjate dy vjeteve te veprimtarise se saj;
- kur parashikohet ne dispozitat e statutit ose aktin e themelimit;

Neni 39

Kur vendoset shkrirja e shoqerise, ortaket caktojne likuidatorin ose keshillin e likuidimit, te cilet paraqesin bilancin e likuidimit.

Shoqeria gjate likuidimit mban shenimin "shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerise krijon pasoja ndaj te treteve mbas dates se publikimit te prishjes ne regjistrin tregetar.

Neni 40

Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit per te vendosur bilancin financiar perfundimtar, aktin e rregullshmerise se likuidimit dhe heqjen e mandatit te likuidatorit.

Neni 41

Kur ortaket nuk vendosin per aktet e mbylljes se likuidimit, likuidatori ose cdo person tjeter i interesuar, kerkon mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes se likuidimit se bashku me llogarite perfundimtare, depozitohen ne regjistrin tregetar.

Neni 42

Mbas mbyljes se likuidimit dhe depozitimit te dokumentave ne regjistrin tregetar, shoqeria c'regjistrohet prej tij.

**VIII. DISPOZITA TE FUNDIT**

Neni 43

Likuidatori eshte pergjegjes per demet qe i shkakton shoqerise nga gabimet qe ka bere ne ushtrimin e detyres e funksionit te tij. Ai pergjigjet edhe per demet qe u shkakton te treteve gjate periudhes se likuidimit duke vepruar me kete cilesi.

Padia kunder likuidatorit parashkruhet me kalimin e afatit 3 vjecar nga data kur eshte kryer veprimi i demshem, ose nga data e zbulimit kur ka qene i fshehur.

Ne rastet kur veprimi i demshem perben krim,padia parashkruhet me kalimin e 10 vjeteve.

Neni 44

Nepunesit e shoqerise si dhe te ngarkuarit me pune prej saj ose nga ortaket, dhe personat e tjere qe punojne per llogari te saj,mbajne pergjegjesi penale kur kosntatohet se me dashje shkelin detyrat e ngarkuara, qe i shkaktojne humbje shoqerise,ose me ndergjegje paraqesin te dhena te paverteta.

Neni 45

Statuti hyn ne fuqi mbas regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar ku depozitohet edhe kopja e tij.

## ORTAKET THEMELUES

(Enjti Pazaj) (Aleksandros BALAPANIDHIS)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER PUBLIK
Nr 1164 rep. 206 kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me daten 26.02...2003 Ne Pogradec, para meje u paraqiten shtetasit Enjti Pazaj, i datelindjes 1954, lindur ne Vlore dhe banues neKorce, mbajtes i pashaportes Nr. Z 0166930 dhe Aleksandros Balapanidhis i datlindjes 1974, lindur dhe banues ne Ptolemaidhe (Greqi) mbajtes i pashaportes Nr. N 813723 te cilet deklaruan se jane dakort me Statutin e mesiperm dhe e kane nenshkruar ate me doren e tyre, me vullnet te lire e te pavarur, duke kerkuar edhe noterizimin e tij.

Meqenese nga ana ime nuk shihet ndonje pengese ligjore,vertetoj sa me siper dhe noterizoj kete akt.

Noter
Thoma BICJA

PULLE TAKSE
100
LEKE
R. SHQIPERISE

# KERKESE

**Kerkuesi** : **Enjti PAZAJ** , në cilësinë e administratorit të shoqërisë "ESSEL "SHpk Korçë .

**Objekti** : Kërkohet rregjistrimi dhe depozitimi i ndryshimeve në pronësinë e shoqërisë sipas kontratës së shitblerjes me Nr. ____rep. e _____Kol. të dt 01.07.2004 si dhe depozitimin e Vendimi Nr. 1 datë 01.07.2004 të Ansamblesë së Shoqërisë Tregëtare "ESSEL "SHpk Korçë.

Kerkesa bazohet ne Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " dhe Ligjin nr.7667 date 28.1.1993 " Për rregjistrin tregëtar " .

**GJYKATES SE SHKALLËS SË PARË**
**T I R A N Ë**

Shoqëria tregëtare "ESSEL"SHpk është rregjistruar si person juridik , me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Nr. 29.207 datë 03.03.2003, me kapital themeltar 100.000 lek në pronësi të dy ortakëve themelues , në kushtet e kontratës datë 20.02.2003 të lidhur midis tyre ku janë të barabartë me 50 % vetëm për shpërndarjen e fitimit nga cikli i prodhimit që realizohet nga aktiviteti i shoqërisë , me objekt veprimtarie "- Prodhimi dhe tregëtimi i bojrave , llakut , plastikove, stukove, etj., dhe materialeve të ndryshme të ndërtimit.; - Tregëti të artikujve të ndryshëm te ndërtimit, industriale ,ushqimore dhe bujqësore me shumicë dhe pakice; - Tregëti i karburanteve me pakicë, pijeve alkolike e freskuese , të duhanit apodhe konfeksioneve ; - aktivitete të ushqimit social si bar kafe, restaurante, hotele e motele ; aktivitete të ndryshme turistike si për transporte turistë dhe mallra të ndryshme brenda e jashtë vendit , import – eksporte ".

Me kontratën e shitblerjes Nr. _____Rep _____Kol të datës 01.07.2004 ortaku Aleksandros BALAPANIDHIS në cilësinë e shitsit, ka shitur tek ortaku blerës Enjti PAZAJ pjesën e tij prej 50 % të kapitalit të nënshkruar , ose 1 / 2 e këtij kapitali , ose e shprehur në vlerë 50.000 lekë . Në këtë mënyrë ortaku blerës Enjti PAZAJ , mbas blerjes së pjesë , në shoqëri ngelet **ortak i vetëm themelues** , i cili zotëron në shoqëri si pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë 100 % të tij , kurse ortaku shitës Aleksandros BALAPANIDHIS largohet nga shoqëria.

Gjithashtu ka lindur nevoja e ndryshimeve në vlerësimin e kontributeve në natyrë të investuara kryesisht nga ortaku Enjti PAZAJ, dhe për efekt të vlerësimit të tij dhe realizimin e transaksionit për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, të emërohet si Ekspert Kontributesh , Eksperti Kontabël i Autorizuar z.Bashkim GJATA .

Bashkangjitur kerkeses paraqitim kopjen e Kontratës së shitblerjes të kapitalit e shoqërisë Nr._____rep. ___kol. , si dhe Vendimin e Ansamblesë së ortakëve Nr. 1 datë 01.07.

Ngelemi me shprese se kerkesa jonë do te merret parasysh.

Korçë , më 05.07.2004

**KERKUESI**
**ADMINISTRATORI**
**( Enjti PAZAJ )**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
"ESSEL"
Shpk
KORCE ALBANIA

# VENDIM

**I ANSAMBLESË SË JASHTËZAKONËSHME TË SHOQËRISË**
**" ESSEL " SHpk Korçë**

Nr 1 Datë 01.07.2004

Ansambleja e ortakëve të shoqërisë " ESSEL " SHpk , e përbërë nga zotërinjtë Enjti PAZAJ dhe Aleksandros BALAPANIDHIS , zotërues të kapitalit themltar të shoqërisë në pronësi , mori në shqyrtim rendin e ditës :

-Miratimin e kontratës së shitblerjes Nr. ______Rep _____Kol të datës 01.07.2004, për shitjen e 50 % të pjesës së kapitalit themeltar të shoqërisë nga ortaku Aleksandros BALAPANIDHIS .

- Emërimi i Ekspertit të kontributeve në natyrë , për vlerësimin dhe zmadhimin e kapitalit themeltar tw nwnshkruar , dhe mbas diskultimeve , u

VEREJT SE :

